



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Vend. nr. 01 / 934 Dt. 15 / 05 / 2023

Në bazë të nenit 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1.2., të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan, Senati i Universitetit, në mbledhjen e XLIII të mbajtur më datë 27.02.2023, mori këtë:

VENDIM

Prof. Asoc. Dr. Sadik Haxhiu zgjidhet në thirrjen akademike **Profesor i Rregullt** për lëndë nga fusha kushtuese administrative në Fakultetin Juridik në Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjilan.

Zgjedhja është bërë në pajtim me kushtet e parapara në nenin 168, 169 dhe 170 të Statutit të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan dhe Rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref.nr. 01/742 të datës 28.04.2022.

I përmenduri është i obliguar që t'u përmbahet dispozitave të Statuti të Universitetit.

Emërimi bëhet për kohë të pacaktuar.

Të përmendurit i takon paga në pajtim me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik Nr. 08/L-196 të datës 05.01.2023 (aplikohen dispozitat tranzitore, Neni 41 për shtesa tranzitore).

Kontrata e punës do të lidhet në pajtim me dispozitat pozitive.

Arsyetim

Universiteti Publik "Kadri Zeka" në Gjilan ka shpallur konkurs Ref.nr. 01/138 të dt. 25.01.2023, për zgjedhjen/rizgjedhjen e avancimit të personelit akademik një mësimdhënës nga fusha kushtetuese administrative në Fakultetin Juridik për lëndët: Fillet e së drejtës; Sistemi gjyqësor dhe profesionet e lira; E drejta kushtetuese; Gjyqësia kushtetuese dhe E drejta administrative, në Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjilan.

Komisioni recensues dhe Komisioni i studimeve i ka propozuar Senatit të Universitetit që Prof. Asoc. Dr. Sadik Haxhiu i plotëson kushtet për t'u zgjedhë në thirrjen akademike Profesor i Rregullt për lëndët e sipërpërmendura.

Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, duke i marrë për bazë vlerësimin e Komisionit Recensues dhe propozimin e Komisionit të Studimeve sipas raportit Ref.nr. 05/812 të datës 24.04.2023, vendosi që Prof. Asoc. Dr. Sadik Haxhiu të zgjidhet në thirrjen akademike Profesor i Rregullt.

Në bazë të kësaj që u tha më sipër u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit në web faqe, Komisionit për Ankesa dhe Parashtrës të Senatit të Universitetit.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Të përmendurit
2. Zyrës së personelit
3. Arkivit të Universitetit
4. Zyrës së financave



Prof. Dr. Bajram Kosumi, rektor
Kryesues i Senatit